

Tetor/2020
Obiliq

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KOMUNA E OBILIQIT-zyra e prokurimit Rr. „Adem Jashari”15000- Obiliq

(vazhdim “Autoriteti Kontraktues”), ne njerën anë;

dhe

Jusuf Berisha, B.I D.SH.,DDD", Adresa: Musinë Kokalari nr.2, 20000, PRIZREN

Kosovë NRB. 810589038 Përfaqësuar nga: Jusuf Berisha Drejtor

(ne vazhdim “Furnizuesi), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

TITULLI I KONTRATËS: Dezinsektim,Deratizim dhe Dezinsektim I objekteve në Obiliq 50000 m²

me numër identifikues: **OB614-20-6585-2-2-5 & Nr i brendshëm 614 20 069 225**

Numri i kontratës:069/2019

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

[Dezinsektimi,Dezinsektimi dhe Deratizimi në institucionet publike Komunale 65.217.39 m²

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **[14 347,83] €; [katrumbdhjetmi e treqind e dyzet e shtat Euro. 83/100]**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

¹ Para nënshkrimit të Kontratës “kjo Draft Kontrate” duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [angleze][shqipe][serbe]² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Sherif Hoti	Emri:	Jusuf Berisha
Pozita:	ZPP	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.10.2020	Data:	30.10.2020
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofruesi i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë

implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorur është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë

ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafët të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës.

Periodha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja

brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Kontratës	Përgjithshme të	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	i	Nr. Nenit
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	i	2.1
		Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
		2.2
		Gjuha e përdorur do të jetë [gjuha e procedurës - shqipe].
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	dhe i	6.1
		Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet mbrenda dite dhe sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit nga AK, me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.
		OE duhet të ketë parasysh se ndodhë që shërbimet do të kërkohej të kryhen edhe naten,pasi që kem të bëjmë megjendjen e pandemisë,për shkak të parandalimit të virusit
		6.4
		Data e Përfundimit është [mbrenda 45 dite].
		6.5
		Vendi i kryerjes së shërbimeve është [Në të gjitha institucionet publike në teritorin e Obiliqit
Ndërprerja Kontratës Autoriteti kontraktues	e nga	9.1
		Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:
		(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
		(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve	nga	10.1
		Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;
		a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
Obligimet Ofruesit Shërbimeve	e të	11.1
		Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.
		11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues

			për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi. 11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.
Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve		10.1	Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues; a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguheshin në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
Obligimet Autoriteti Kontraktues	e	12.1	Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave. 12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës. 12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i me vendim, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues
Dëmet likuiduara	e	13.1	Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore 0.25% për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria ekzekutimit	e	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është <i>[shëno shumën e sigurisë së ekzekutimit]</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	i	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: Nënktraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, për çdo mospermbushje të kontratës sigurimi i ekzekutimit do të konfiskohet
Parimet përgjithshme të pagesës	e	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>[mbas çdo situacioni të përfunduar]</i>
Kontrolli kualitetit	i	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuuese e defekteve është +30 ditë nga përfundimi i kontratës
Konsekuencat e Shkeljes se kontratës	e	19.1	Konsekuencat e Shkeljes se kontratës 19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

			19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime: a) dëmet; dhe/ose b) ndërprerjen e kontratës. 19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë: a) Dëme të përgjithshme; ose b) Dëme të likuidueshme. 19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes		20.2	[Me marreveshje]
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore		21.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

PJESA V E KONTRATËS:

IDENTIFIKIMI FINANCIAR

PJESA V E KONTRATËS:

IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	D.S.H. D.D.O. "Kosovo"
Adresa	Mirësi Kshajari Nr 2
Qyteti	Prizren
Kodi Postar	20000
Kontakti	
Telefoni	044-212-101
Fax	
E-mail	joshufb10@gmail.com
Numri i TVSH	330245875

BANKA	
Emri	D.S.H. D.D.O.
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	1502001000881869
IBAN (opcionale)	XK051502001000881869
BIC (Opcionale)	RBR0XKPR

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PERFAQËSUESIT TË BANKËS (të dyja të obligueshme)


DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)


PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: OB614-20-6585-2-2-5

Titulli i kontratës: Dezinfektimi,Dezinsektimi dhe Deratizimi në institucionet publike Komunale

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë

nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Dezinfektimi,Dezinsektimi dhe Deratizimi në institucionet publike Komunale

3. Çmimi total i tenderit është:

14 347,83 EURDhe në fjalë [katrumbdhjetmi e treqind e dyzet e shtat Euro. 83/100]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 45 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Edhe në Komunën e Obiliqit sikur në pjesën më të madhe të Kosovës në vazhdimësi prej viti në vit paraqiten sëmundje të ndryshme ngjitëse si: tularemia, ethet hemoragjike, gjithashtu këtë vit (2020) është edhe virusi (COVID- 19) dhe një numër i madh i sëmundjeve tjera ngjitëse të traktit digjestiv dhe atij respirator. Një nga rrugët e përhapjes së këtyre sëmundjeve është edhe ajo e cila realizohet përmes vektorëve, të cilët mund të jenë të ndryshëm: brejtës, insekte rrëshqitëse dhe insekte fluturuese si: mizat, mushkonjat etj. Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve që mund të shkaktojnë

dëmtim të shëndetit të popullatës, drejtorati ka paraparë aktivitete të ndryshme nga lëmi i shëndetit publik e një ndër to është edhe zbatimi sistematik i veprimeve të DDD me qëllim të eliminimit apo sjelljes në kufijë të tolerancës epidemiologjike. Përmes këtij projekti synohet parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse përmes vektorëve dhe përmirësimi i kualitetit të jetës për qytetarët e komunës sonë. Për aksion efikas duhet të plotësohen disa kushte si: kushtet mikrometeorologjike, aplikimi i standardeve të parapara në kontekst të preparatit dhe metodës së aplikimit dhe karakteristikat e insekteve. Pastaj shumë me rëndësi është edhe përcaktimi i gjendjes reale i cili nënkupton identifikimin e insekteve që janë qëllim i eliminimit, përcaktimi i lokalitetit dhe vatrave, planifikimi i trajtimit, përcjellja e kushteve mikrometeorologjike,

Q Ë L L I M I

Me këtë projekt synohet që të arrihen këto qëllime:

- ✓ Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe (pandemia me COVID-19)
- ✓ Eliminimi ose sjellja në kufijë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese
- ✓ Parandalimi dhe pengimi i përhapjes së sëmundjeve transmiseve që barten përmes insekteve që shëbejnë si vektorë.
- ✓ Krijimi i kushteve për jetë më të qetë të qytetarëve.

AKTIVITETET

DDD, duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin publik. Duhet përdorur metodat më bashkëkohore me mjete të sofistikuara me aplikim. Gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e OBSH dhe CDC (Centre for Disease Control) (Qendra për kontrollin e Sëmundjeve). Në përzgjedhjen e preparatit duhet bazuar në rekomandimet OBSH-së, me shkallë të lartë të sigurisë. Doza e materies aktive duhet të jetë qartë e përcaktuar në specifikimet e produktit dhe në përputhje me rekomandimet nga OBSH-ja dhe legjislacioni i BE-së

Dezinsektimi

- Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjërë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese si në bazë të :
 - H₂O₂ (peroksidit të hidrogjenit),
 - Komponentet aktive të amoniumit,
 - Hipoklorit natriumi.
 - Dezinsektimi në IPK ,me preparate të klorit/ zbardhues / shkatërron mikrobet.Të përdoren tretjet e dezinfektantit klorik: 0.05% ose 0.5%. Tretja 0.5% shkatërron shpejt mikroorganizmat,ndërsa tretja 0.05% i shkatërron ato brenda 30 minutave. **Kalcium Hipoklorid 70%(granulat ose pluhur)**

Preparati Kalcium Hipoklorid 70%(granulat ose pluhur)

Tretja 1:10 (0.5%)

- Rroba të ndotura
- Toaletet
- Lëngjet trupore, ekskretet, të vjellurat,
- Dyshemetë, mjedisi

Tretja 1:100 (0.05%)

- Duart, lëkura dhe mbathjet
- Termometrat
- Rrobet në lavanderi
- Pjatat, enët e kuzhinës.

- Preparatet Dezinfektuese duhet të kenë Certifikatë të A-Testit, afat të përdorimit.
- Të jenë preparate që mund të përdoren në hapësira e institucioneve publike komunale
- Preparatet duhet të jenë të aplikueshëm përmes aparaturës ULV – ELEKTROSTATIKE (shpërndarës i spërklave në formë uniforme).

- Preparatet duhet të kenë veprim: baktericid, fungicid, virucid dhe kundër sporeve.
- Preparatet dezinfektuese duhet të përdoren në bazë të udhëzuesit të produktit, i cili caktohet nga prodhuesi.

Dezinsektimi

- Preparati i përdorur për dezinfektim është preparati **Aqua Kontrol** preparati në fjalë është i lejuar nga organizata botërore e shëndetësi (OBSH) për përdorim në hapësira publike, është i padëmshëm për njerëz ,

Deratizimi

- Për Deratizim të e objekteve duhet të përdoret preparati **Deratizues –rodenticid-antikuagulant** i gjeneratës së dytë.
- Preparati deratizues të ketë Certifikatë të A-testit
- Preparati deratizues duhet të vendoset në shtëpiza (kutia)të vogla dhe të mëdha .
- Preparati duhet të vendoset në sasi prej 16gr-24gr në 1m²
- Në vend ku ndjeshmëria është e lartë , duhet të vendosen në ngjitës special.

PERSONELI – KAPACITETET PROFESIONALE

Për kryerjen e DDD shërbimeve personeli duhet te jetë:

- Një Epidemiolog me diplomë universitare (të noterizuar), licencë pune (të noterizuar) së paku një vit përvojë pune dhe me kontratë valide.
- Një teknik sanitar me licencë pune (të noterizuar) me së paku një vit përvojë pune dhe me kontratë valide.
- Dy punëtor të certifikuar për përdorim të produkteve biocide
- Tre punëtor të certifikuar për IPM (Integritet Pest management), në lëmin e DDD me diploma ose certifikata të noterizuara.
- Një punëtor I diplomuar (diploma e noterizuar) në menagjimin e emergjencave me tri vite përvojë pune.

OE DUHET TË POSEDOI DHE TË DËSHMOI:

- Licencën e lëshuar nga MBPZHR për përdorimin e preparateve dhe kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës.
- Lejen e importit për produkte biocide të lëshuar nga MMPH.
- Të jetë I certifikuar me standardet ISO 9001 2015; ISO 14001 2015 dhe OHSAS 18001 2008 për cilësinë e shërbimeve të DDD.

DDD SHËRBIMET

Vërejte: Çdo OE duhet të dëshmoj prejardhjen e preparatit të ofruar për shërbime, ateste e tij Certifikatën e cilësisë, deklaratën e prodhuesit, afatin e përdorimit. OE për çdo dëm të shkaktuar do të bartë të gjitha pasojat .



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry



CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810589038

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Jusuf Berisha B.I.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

D.SH. "D.D.D."

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Biznes individual
Individualno preduzeće
Individual business

Adresa:
Adresa:
Address:

MUSINE KOKOLLARI 2
Prizren

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

05/04/2002

13/06/2019

Data / Date / Datum



Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10034485



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë
Departman Poljoprivrednih Politika i Trgovine
Department of Agriculture Policy and Trade

Data: 30.07.2020
Ref. 04.5-257/20

Drejtori i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21.10.2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011),nenin 5 (paragrafi 5.4.c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, në pajtim me nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve të dt. 17.01. 2013 si dhe kërkesës së parashtruar me **JUSUF BERISHA B.I** me 3018 të dt 28.07.2020 në bazë të procesverbalit dt. 30.07.2020 të Komisionit për Licencim të Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë, nxjerr këtë:

Për dhënien e lejes së përkohshme

1. I LEJOHET PËRKOHËSISHT operatorit parashtruar **JUSUF BERISHA B.I** me seli ne Prizren për kryerja e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit.
2. Kryerja e punëve profesionale të përcaktuara nga pika 1 e këtij vendimi, lejohet në afat të caktuar nga dt. 30.07.2020 deri më 30.01.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtori i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë,duke u bazuar në kërkesën e ushtruar nga operatori parashtruar **JUSUF BERISHA B.I** seli në Prizren nr. 3018 të dt. 28.07.2020 dhe dokumentacionit të bashkangjitur (Certifikata e regjistrimit të biznesit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Informata mbi biznesin nga Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregtarë në Kosovë; Certifikata e numrit fiskal nga Ministria e Financave dhe Diploma e Fakultetit të Bujqësisë, Agronomisë, Veterinarisë, Epidemiologjisë dhe Ekologjisë), për kryerjen e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit, në pajtim me nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve, të dt. 17.01.2013 dhe në mungesë të aktit nënligjor që e përcakton rregullimin e kësaj fushe, merr vendim që ti lëshohet **leje e përkohëshme** për kryerjen e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në afat të caktuar nga dt.**30.07.2020** deri më **30.01.2021**

Me sa u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të Operatori parashtruar **JUSUF BERISHA B.I** me seli në Prizren.
- Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë.

MasterLine®

By Univar

AQUA-KONTROL CONCENTRATE

Për mushkonjat, mizat dhe mizat e vockla

Një piretroid sinergjik me reagim të shpejtë, me pak erë, jo korroziv për parandalimin e mushkonjave të rritura në hapësirat banuese, rekreative dhe të tjera. Gjithashtu për përdorim kundër mushicave dhe mizave të zeza thumbuese dhe jo-thumbuese.

Për përdorim vetëm nga zyrtarët qeveria federal, shtetëror, fisnor ose lokal përgjegjës për shëndetin publik apo kontrollin vektorial, ose nga personat e certifikuar nga agjencia kryesore rregulluese shtetërore ose fisnore e pesticideve për aplikimin e parandalimit të mushkonjave të rritura ose nga personat nën mbikëqyrje të drejtpërdrejt.

PËRBËRËSIT AKTIV:

* Permethrinë20.0% *

** Piperonyl Butoxide, Teknik20.0%

PËRBËRËSIT E TJERË**60.0%

GJITHSEJ100.00%

*(3-fenoksifenil)metil(+/-) cis/trans 3-(2,2-dikloroetenil)(2,2 dimetil ciklopropanecar-boksilat. Cis/trans përpjesëtimi: min.35%(+/-)cis dhe maks. 65%(+/-) trans.

*** (butilkarbitil)(6-propilpiperonil) etër dhe 4.0% përbërës të ndërlidhur

*** Përmban distilat vajguri

Përmban 757 gramë permethrinë dhe 757 gramë piperonil butoksid për një galon (3.785 litra)

MBAJENI LARG FËMIJËVE

KUJDES

Shihni brenda libërthin e bashkëngjitur për masat shtesë të kujdesit

NDIHMA E PARË

Nëse gëlltitet:	Menjëherë thërrisni qendrën helmim parandaluese ose mjekun. Mos e nxisni vjelljen pos nëse ju është thënë nga qendra helmim parandaluese ose mjeku. Mos i jepni asnjë gjë të lëngshme personit. Mos i jepni asgjë përmes gojës personit të alivanosur.
Nëse në sy:	Mbajeni kapakun e syrit hapur dhe shpëlajeni ngadalë dhe lehtë me ujë 15-20 minuta. Hiqini kontakt thjerrat nëse ka/keni pas 5 minutave të para, pastaj vazhdoni ta shpëlani syrin. Thërrisni një qendër helmim parandaluese ose mjeku
Nëse në lëkurë	Zhvishini rrobat e kontaminuara. Lajeni lëkurën menjëherë me shumë

ose rroba:	ujë rreth 15-20 minuta. Telefononi qender për parandalim helmimi ose mjekun për këshilla trajtimi.
NUMRA E EMERGJENCES	
Kur e mundur, merreni me vete kontejnerin ose etiketën kur i telefonin qendrës për parandalim helmimi ose kur shkon në trajtim. Për informata shtesë për këtë pesticid (përfshirë shqetësimet shëndetësore, urgjencat mjekësore ose shqetësimet për pesticidin) mund të telefononi në 1-8000-222-1222, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë.	

Prodhuar nga: **Univar Environmental Sciences**
11305 Four Points Drive, Building 1 Suite 210, Austin, TX 78726

EPA Nr. i regj. 73748-1

**KËSHILLA KUJDESË
RREZIKU NDAJ NJERËZVE DHE
KAFSHËVE SHTËPIAKE:
KUJDES:**

I dëmshëm nëse gëlltitet. Shmangni kontaktin me sytë, lëkurën ose rrobat. Pastrohuni mirë me sapun dhe ujë pas përdorimit dhe para se të hani, pini, të përtypni çamçakëz, të përdorni duhanin. Vishni këmbisha mëngëgjata dhe pantallona të gjata, çorape, këpucë dhe dorëza rezistuese ndaj preparateve kimike nga materiali ujë-rezistuese si dorëza të plastifikuara, të gomës butil, gomës biril, gomës neopren, gomës natyrale, polietilen, PVC (poliviniklorid) ose viton.

Pajisjet personale mbrojtëse (PPM)

Disa materiale që janë rezistuese ndaj këtij produkti janë laminati, goma nitril më e madhe ose baras me 0.35 mm ose goma neopren më e madhe ose baras me 0.35 mm. Nëse doni më shumë opsione, ndiqni instruksionet për kategorinë E në tabelën EPA për përzgjedhjen e kategorisë së rezistuesit kimik.

Përzierësit, ngarkuesit, aplikuesit dhe përdoruesit e tjerë duhet të veshin këmbisha mëngëgjata dhe pantallona të gjata, këpucë, çorape, dorëza rezistuese ndaj kemikateve për të gjithë përdoruesit pos aplikuesve që përdorin pajisje tokësore motorike, dhe përparësja rezistuese ndaj kemikateve për përzierësit/ngarkuesit, personat që i pastrojnë pajisjet dhe personat e ekspozuar ndaj përqendrimit.

Masat e sigurisë të përdoruesit

Zbatoni udhëzimet e prodhuesit për pastrim/mirëmbajtjen e pajisjen personale mbrojtëse. Nëse s'ka udhëzim të largës, përdorni detergjent dhe ujë të ngrohtë. Këtë pajisje mbajeni dhe lajeni ndaras nga rrobat e tjera.

Hidhni rrobat dhe materialet e tjera absorbuese që janë qullosur ose kontaminuar me përqendrim të këtij produkti. Mos i ripërdorni ato.

Rekomandimet për sigurinë e përdoruesit:

- Përdoruesit duhet t'i lajnë duart me sapun dhe ujë pas përdorimit dhe para ngrënies, pirjes, përdorimit të çamçakëzit, duhanit, tualetit.
- Përdoruesit duhet t'i zhveshin rrobat menjëherë nëse pesticidi futet brenda. Pastaj lajini ato mirë dhe vishni rroba të pastra.
- Përdoruesit duhet t'i zhveshin rrobat mbrojtës menjëherë pas përdorimit të produktit. Lajini dorëzat nga jashtë para se t'i hiqni. Sa më shpjet e mundur lahuni mirë dhe vishni rroba të pastra.

Masat mbrojtëse parandaluese

Pilotët duhet të rrinë në kabinë të mbyllur që i përmbushë kërkesat sipas standardeve të mbrojtjes së punëtorëve (WPS) për pesticidet bujqësore (40 CFR §170.240(d)(6)).

Ndalohet flamurin ta valojë njeriu. Përdorimi i flamurit për të ndihmuar

aplikimin nga ajri kufizohet në përdorimin e GPS ose famujve mekanik.

RREZIQET MJEDISORE

Pesticidi është jashtëzakonisht toksik për peshqit dhe butakët ujor. Për mbrojtjen e mjedisit mos lejoni pesticidi të derdhet në kanalizimet e ujërave të shiut, në kanalizime, ose ujëra sipërfaqësor. Aplikimi i këtij produkti në mot të qetë dhe kur shiu nuk parashihet 24 orët e ardhme do të ndihmojë që era ose shiu të mos e bartin ose shpëllajnë pesticidin nga hapësira e trajtimit. Shpëllarja e pajisjeve të aplikimit në hapësirën e trajtuar ndihmon mos derdhjen e tij në trupa të tjerë ujor dhe sistemet e drenimit.

Ky pesticid është shumë toksik për bletët nëse bimët e lulëzuara ose barishtet trajtohen drejtpërdrejt. Mos e aplikoni ose mos lejoni ta bart era të bletët ose barishtet me të cilat ushqehen bletët.

RREZIQET MJEDISORE NGA APLIKIMI I ADULTICIDIT TË MUSHKONJAVE NË HAPËSIRË TË MADHE

Pesticidi është jashtëzakonisht toksik për peshqit dhe butakët ujor. Dërdhet nga hapësirat e trajtuara ose depozitimi i pikave të sprejit në trup ujor mund të jetë i rrezikshëm për peshqit dhe butakët ujor. Kur bëhet aplikimi i adulticidit të mushkonjave në hapësirë të madhe, para aplikimit të parë në sezone, duhet konsultuar agjencinë shtetërore ose fisnore me përgjegjësi primare për rregullimin e pesticideve për të caktuar nëse ekzistojnë rregullat e caktuara.

Kur e aplikoni adulticidin e mushkonjave në hapësirë të madhe, mos e aplikoni mbi trupat ujorë (liqenet, rezervuarët, lumenjtë, gurrat, kënetat ose pellgjet natyrore, moçulet, kënetat, grykëderdhjet dhe hordhat e peshqve) por kur është nevoja të shënjohen hapësirat ku janë të pranishme mushkonjat e rritura, dhe kushtet e motit do ta lehtësojnë lëvizjen e materialit të

aplikuar larg nga uji që të minimizohet depozitimi incidental në trupin ujor.

Rreziqet fizike dhe kimike

Nuk digjet

Udhëzime për përdorim

Konsiderohet shkelje e ligjit federal të përdoret ky produkt në mënyrë joadekuate me etiketën e tij:

Restriksionet e përdorimit:

- Aplikoni këtë produkt siç është specifikuar në etiketë.
- Mos e kontaminoni ushqimin ose ushqimin e kafshëve.
- Aplikimi i këtij produkti ndalohej me përdorimin e pajisjes mjegulluese të ftohtë ose termale të dorës.
- Ky produkt nuk është për përdorim me mjetet spërkatëse mjegulluese.
- Mos e aplikoni si trajtim të përbapur ose pikash në hapësirat e brendshme nëpër godina banimi, përkishirë shtëpi e pleqve, qendrat e kujdesit dhlor, shkollat, spitalet dhe qeridhe të mjesh.
- Pos kur aplikohet për parandalim mushkonjash, mos hyni dhe mos i lejoni të tjerët të hynë në hapësirën e trajtuar derisa spreji të jetë terur.
- Pos kur aplikohet për parandalim mushkonjash, mos hyni dhe mos i lejoni të tjerët të hynë në hapësirën e trajtuar derisa avujt, mjegullinat dhe aerosolët të jenë shpërndarë dhe hapësirat e trajtuar të jenë ajrosur mirë.
- Pos kur aplikohet për parandalim mushkonjash, mos e aplikoni këtë produkt ashtu që do t'i kontaktojë punëtorët dhe personat e tjerë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose përmes bartjes.
- Aplikimi i këtij produkti ndalohej drejtpërdrejt në kanalizime ose drenazhe, ose në ndonjë hapësirë si ollu ku ujërat e shiut derdhen, në trupat ujor ose në mjedisin ujor. Mos lejoni që ky produkt të futet në asnjë kanal kullues gjatë ose pas aplikimit.
- Largoni kafshët e qejfit, zogjtë dhe mbulonit akuariumet dhe pellgjet

zhukurues të peshqve para spërkatjes, dhe shkyçeni sistemin e akvariumit pra përdorimit.

- Pos kur aplikohet për parandalim mushkonjash, vetëm përdoruesit e mbrojtur mund të jenë në hapësirë gjatë aplikimit.
- Aplikimi ajror i këtij produkti është i ndaluar në shtetin Florida pse nëse autorizohet enkas nga Biroja e Entomologjisë dhe parandalimi të dëmtesave, Departamenti i Floridës për bujqësi dhe shërbimet e konsumatorëve.

KUSHTET JO-BUJQËSORE TË PËRDORIMIT

Kushtet në këtë rubrikë kanë të bëjnë me aplikimin e këtij produkti që nuk janë në kuadër të standardeve të mbrojtjes së punëtorëve për pesticidet bujqësore (40CFR Pjesa 170). Këto standarde aplikohen kur ky produkt përdoret për prodhimin e bimëve bujqësore në femra, pyje, fidanishtet dhe serrat.

Personat e pambrojtur mbajini larg hapësirave të trajtuara derisa spreji të jetë terur. Vishni robra mbrojtëse kur ta përdorni produktin për të evituar ekspozimin e syve dhe lëkurës ndaj produktit. Mbrojtja e syve, dorëzat, këmbisha mëngëgjatë dhe pantallonat e gjata rekomandohen.

Lejoni sprejin të teret para se t'i lejoni të rriturit, fëmijët ose kafshët e qejfit të shkojnë në hapësirën e trajtuar.

Për ndonjë kusht specifik të shtetit apo fisit tuaj, konsultohuni me agjencinë përgjegjëse për përdorimin e pesticideve.

KUSHTET DHE PËRMASAT E PËRDORIMIT PËR PARANDALIMIN E MUSHKONJAVE

AQUA-KONTROL KONCENTRATI mund të përdoret për parandalimin e mushkonjave të rritura, mizave dhe mizave të vogla në programet për parandalimin e mushkonjave përfshirë hapësirat e banimit, industriale, komunat, parqet, kampet, pyjet, fushat sportive, fushat e golfit, kopshet, fushat e lojës, vendet rekreative,

deponitë e mbeturinave dhe vendet e tjera ku paraqiten mushkonjat. Për rezultate më të mira, trajtoni kur insektet janë më aktive dhe kushtet janë të favorshme të mbahet megjulla afër tokës.

AQUA-KONTROL KONCENTRATI është krijuar të përzihet me ujë ose të përdoret e papërzier dhe të aplikohet si ULV ose sprej. **AQUA-KONTROL KONCENTRATI** qëndron plotësisht e zbërthyer dhe nuk do të ndahet në kushte normale depozitimit. Por nëse ka shenja ndarjeje, tundeni ose trazojeni mirë për të përfituar një përzierje të njëtrajtshme. **AQUA-KONTROL KONCENTRATI** nuk përmban distilat aromatike ose të petroleumit alifatik.

Mos e përzieni këtë produkt me vaj. Përdorni vetëm ujë të pastër. Mos e tejkaloni përmasën maksimale të përcaktuar në 40 ari sipërfaqe.

Aplikimet tokësore dhe ajrore duhet të bëhen kur kushtet meteorologjike të jenë të favorshme për ta mbajtur renën e spërkës afër tokës si p.sh. kur ka inversion të temperaturës së ajrit. Aplikimet gjatë orëve të freskët të mëngjesit të hershëm ose në mbrëmje preferohen. Temperatura e ajrit s'duhet të jetë më e lartë se 10°C kur t'i bëni të gjitha llojet e aplikimeve. Aplikimi në kushtet të ajrit të qetë duhet evituar. Aplikojeni kur shpejtësia e erës është më e madhe se 1 milje(.16 km)/orë. Mos e aplikoni kur era frynë më shumë se 16 km/orë. Aplikimet nuk bën t'i tejkalojnë përmasat e rekomanduara.

Për përdorim vetëm nga zyrtarët qeveria federal, shtetëror, fisnor ose lokal përgjegjës për shëndetin publik apo kontrollin vektorial, ose nga personat e certifikuar nga agjencia kryesore rregulluese shtetërore ose fisnore e pesticideve për aplikimin e parandalimit të mushkonjave të rritura ose nga personat nën mbikëqyrje të drejtpërdrejt.

Mos e ri-trajtoni një vend më se një herë në 3 ditë. Mos i tejkaloni 25 aplikime në

tejkaloji 25 aplikime prej 3.17 gr. permetrin në 40 ari (të mos tejkalojë 81 gr permetrin në 40 ari) në cilëndo stinë. Kur shënjohet Aedes Taeniorhynchus dhe speciet e tjera të vështira, aplikimet e preparatit mund të bëhen deri në 36 gramë në 40 ari.

Përdorimi më të shpeshta mund të bëhen për parandalimin apo kontrollin e kërcënimit ndaj shëndetit publik dhe/ose kafshor të konstatuar nga agjencia vektor parandaluese shëndetësore shtetërore, fisnore ose lokale në bazë të provave të dokumentuara të agjentëve që shkaktojnë sëmundje të vektor mushkonjat ose paraqitjen e sëmundjeve që barten përmes ajrit nga mushkonjat të kafshët ose njerëzit, ose nëse aprovohet në mënyrë specifike nga shteti ose fisi gjatë përpjekjes për t'i shpëtuar ndonjë fatkeqësie natyrore.

AQUA-KONTROL KONCENTRATI mund të aplikohet te bimët specifike dhe kullosat para kositje për parandalimin e mushkonjave të rritura dhe mizave thumbuese brenda ose afër këte hapësirave.

Aplikime mund të bëhen ku janë të pranishme këto bimë:

Jonxha	Bari i gjatë
Bajameti	Perime gjetthore
Mollët	Rrepa
Karçofi	Perimet gjetthore (pos brasikës)
Avokado	Marule
Brokoli	Kërpudha
Lakra Brukseli	Qepë, të vjetra
Lakra	Pjeshka
Selino	Dardha
Lulelakër	Specia, dollma
Qershii	Sojë
Taxhi misri	Domate
Foragjere misri	Perime, kungull
Misër kokërr	Arra
Patëllxhan	Spinaqi
Lajthi	fëstëk
Hudhër	

Në trajtimin e vathëve, vendeve ushqyese, stallave të derrave, vendin ushqyës të pulave dhe kopshtet zoologjike, mbuloni ujën e ekspozuar të pijshëm, krojet dhe ushqimin kafshor para aplikimit. Mos i kontaminoni vendet e pamiratuara me sprej.

UDHËZIMET PËR APLIKIMIN TOKËSOR(Aplikimi Jo-termal) KALIBRIMI I MADHËSISË SË PIKLËS PËR PAJISJET E APLIKIMIT TOKËSOR

Aplikimi tokësor: Pajisja e sprejit duhet të rregullohet ashtu që vëllimi i diametri mestar është më pak se 30 mikrona (Dv 0.5 < 30 µm) dhe se 90% e sprejit përbëhet nga piklat më të vogla se 50 mikronë (Dv 0.9 < 50 µm). Udhëzimet e prodhuesit të pajisjes ose shitësit, regjistruarit të pesticidit ose të institutit testues që përdor instrumente laseri për matje duhet të përdoret për ta rregulluar pajisjen të prodhojë madhësi të pranueshme piklash. Pajisja aplikuese duhet të testohet së paku çdo vit për të vërtetuar se shtypja në pipëz dhe shkalla e rrjedhjes së pipëzës janë kalibruar si duhet.

APLIKIMI JO-TERMAL MJEGULLUES I AEROSOLIT Aplikimi jo-termal mjegullues i aerosolit AQUA-KONTROL KONCENTRAT ULV

Për parandalimin e mushkonjave, mushicave dhe mizave të zeza, aplikoni AQUA-KONTROL KONCENTRAT me përdorimin e aplikatorit standard ULV tokësor i cili mund të prodhojë aerosol sprej jo-termal. Ndryshoni shkallën e rrjedhës sipas dendësisë së vegjetacionit dhe popullatës së mushkonjave. Përdorni rrjedha më të mëdha të vegjetacionit i dendur ose kur popullata është e lartë. Përdorni sistemin e kontrollit të lartë për të pasur shkallë të duhur rrjedhjeje. Një sistem i saktë kontrolli të rrjedhjes duhet përdorur për të pasur shkallë të duhur rrjedhjeje.

AQUA-KONTROL KONCENTRATI gjithashtu mund të

aplikohet duke e tretur në ujë dhe duke e aplikuar ashtu që të mos e tejkalojë peshën maksimale të përbërësit aktiv në 40 ari sipërfaqe siç është paraqitur në shtyllën e parë të tabelës ULV më poshtë. Nëse nevojitet një përmasë alternative tjetër,

rregullojeni shkalën e rrjedhjes, me kusht që madhësia e piklës dhe spektri të mbeten sipas specifikimeve të etiketës. Mund të aplikohet në shpejtësi kamionçine prej 5 deri në 20 milje /orë.

Kushtet dhe përmasat për përdorimin e AQUA-KONTROL KONCENTRATI të papërzier për parandalimin e mushkonjave

PERIMETHRIN/PBO GR/40 AR		PERMASAT E APLIKIMIT/MILILITRA NË MINUTË	
	8 km/h	16 km/h	32 km/h
3.17/3.17	44	91	182
1.58/1.58	22	44	91
0.79/0.79	11	22	44

Përmasat e sugjeruara të përzierjes për AQUA-KONTROL KONCENTRAT

% KONCENTRAT	Pjesë të AQUA-KONTROL KONCENTRATIT	Pjesë të ujit
2%	1	9
4%	1	4

Rrjedha e sugjeruar (ml/min) dhe përmasa e përdorimit për 2% (1 deri në 9 përpjesëtimi i përzierjes) produkt

PERIMETHRIN/PBO GR/40 AR		PËRMASAT E APLIKIMIT/MILILITRA NË MINUTË	
	8 km/h	16 km/h	32 km/h
3.17/3.17	443	Nuk rekomandohet	Nuk rekomandohet
1.58/1.58	230	443	Nuk rekomandohet
0.79/0.79	115	230	443

Rrjedha e sugjeruar (ml/min) dhe përmasa e përdorimit për 4% (1 deri në 9 përpjesëtimi i përzierjes) produkt

PERIMETHRIN/PBO GR/40 AR		PËRMASAT E APLIKIMIT/MILILITRA NË MINUTË	
	8 km/h	16 km/h	32 km/h
3.17/3.17	229	443	Nuk rekomandohet
1.58/1.58	115	229	443
0.79/0.79	59	115	229

Si sprej që përdor njësi të tipit Mister:
Për përdorim të pajisjet jo-termale, aplikoni **AQUA-KONTROL KONCENTRATIN**, e fryrës mjegulle për të prodhuar pikla me vëllim të diametrit mesatar prej 50 – 120 µ. Përdoren të përzierë ose të pa përzier për të përfutur aplikimi e 3.17/3.17 ml # /40 ari. Përdoren një brez prej 15.2 metrash derisa ecni me shpejtësi prej 3.2 km/h. Nëse përdorni shpejtësi tjetër, brez apo përzierje, mos e tejkaloni maksimumin /ari. Kur produkti aplikohet si trajtimi tokësor, mos e aplikoni më afër se 30 metra prej liqeneve dhe lumenjve.

SISTEMET MJEGULLUESE TË HAPËSIRAVE TË JASHTME

Kur përdoret ky produkt instaluesit dhe teknikët e shërbimeve duhet t'i përmbahen licencës, certifikimit ose kushteve të regjistrimit të shtetit (eve), fisit(eve) ose munitetit(eve) lokale ku ato instalohen.

Restriksionet e përdorimit:

- MOS e aplikoni këtë pesticid në hapësirat ku njerëzit, kafshët e qejfit dhe /ose ushqimi janë të pranishëm.
- Mos e përdorni në sistemet ftohëse avulluese.
- Pipëzat drejtojnë në drejtim të hapësirës për t'u trajtuar larg pishinave, trupave ujor dhe hapësirave ku halet dhe zihet.
- Mos e rregulloni pipëzën të hedh mjegullinën afër sistemit të jashtëm të kondicionerit ose hyrjeve të tjera të ajrit në shtëpi.

Nëse përdoret në një sistem me rezervuar për përdorim të përzierjes së fundit, rezervuari i sistemit duhet të mbyllet. Ngjiteni etiketën e pesticidit dhe formulimin e përzierjes në rezervuar të sistemit në hapësirën e mbrojtur nga moti ose në mëngën e plastmasës. Formulimi i përzierjes duhet të parafrazohet kështu: "Ky kontejner përmban 1 masë të aqua-kontrol koncentratit me 219 masa të ujit."

Nëse përdoret në sistem direkt injektues, kontejneri i pesticidit duhet të mbyllet. Bashkëngjithi mirë etiketën në kontejnerin e pesticidit të mbrojtur nga moti ose në mëngën e plastmasës.

Nëse sistemi punon në tajmer automatik, caktojini kohën e aplikimit kur njerëzit, kafshët e qejfit dhe/ose ushqimi nuk janë të pranishëm.

Nëse sistemi funksionon kur personi e drejton teledirigjuesin, atëherë aplikimi i këtij pesticidi ndalohet kur njerëzit, kafshët e qejfit dhe/ose ushqimi nuk janë të pranishëm.

Kontaktojeni prodhuesin e sistemit për udhëzime ose ndihmë për zbatimin e kushteve në vijim:

"Ky sistem mund të përdoret vetëm të sistemet që janë kalibruar të aplikojnë më shumë se masën maksimale të aplikimit prej 0.25 gramëve përmetrin dhe 0.26 gramë PBO në 304 m³ në ditë."

UDHËZIME PËR APLIKIM NGA AJRI

Përdorimi i aeroplanit enkas të pajisur dhe që ka mundësi aplikimi të **ULTRA VËLLIMEVE TË ULËTA** të **AQUA-KONTROL KONCENTRATIT** mund të jetë i nevojshëm.

KALIBRIMI I MADHËSIVE TË PIKLAVE PËR PAJISJET E APLIKIMIT AJROR.

Aplikimi ajro i kryer në lartësinë prej <200 mbi tokë: Pajisja e spërkatjes duhet të rregullohet ashtu që vëllimi i diametrit mesatar të prodhuar është më i vogël se 60 mikronë ((Dv 0.5 < 60 µm) dhe se 90 % e sprejit i përbëjnë piklat më të vogla se 100 mikronë (Dv 0.9 < 100 µm). Efektet e shpejtësisë së fluturimit dhe, për pipëzat jo-rotulluese, këndi i pipëzës në spektrin e lëshimit duhet të merret parasysh. Pajisja aplikuese duhet të testohet së paku çdo vjet për të vërtetuar shtypjen në pipëz dhe shkalla e rrjedhës së pipëzës kalibrohet si duhet.

Aplikimi ajror i kryer në >200 mbi lartësinë e tokës: Pajisja e spërkatjes

duhet të rregullohet ashtu që diametri i vëllimit mestar i prodhuar është më pak se 70 mikronë (Dv 0.5

< 70 µm) dhe se 90% e sprejit përbëhet nga piklat më të vogla se 145 mikronë (Dv 0.9 < 145 µm). Efektet e shpejtësisë së fluturimit dhe, për pipëzat jo-rrotulluese, këndi i pipëzës në spektrin e lëshimit duhet të merret parasysh. Udhëzimet e prodhuesit të pajisjes ose shitësit, regjistruarit të pesticidit ose të institutit testues që përdor një tunel ose instrumente laseri për matje duhet të përdoret për ta rregulluar pajisjen të prodhojë madhësi të pranueshme piklash. Pajisja aplikuese duhet të testohet së paku çdo vit për të vërtetuar se shtypja në pipëz dhe shkalla e rrjedhjes së pipëzës janë kalibruar si duhet. Aplikimi ajror duhet të bëhet në lartësi prej 22 deri në 91 metra. Mos aplikoni përmes aeroplanit me krahë të fiksuar në lartësi më të vogël se 30 metra ose me helikopterit në lartësi më të vogël se 22 metra pos nëse në mënyrë specifike është miratuar nga shteti ose fisi në bazë të nevojave publike shëndetësore.

Aplikojeni në shpejtësi të mjaftueshme ajrore për të shpërndarë sasinë e duhur të preparatit/ 40 ari (nga 0.05 deri në 0.22 ml/40 ari) dhe për të arritur një shtrirje të duhur të piklave. Shpejtësia e fluturimit dhe orientimi i pipëzës duhet të konsiderohet në përcaktimin e madhësisë së piklave. Aplikojeni kur shpejtësia e erës është më e madhe se 1.6 km/h.

Spërkatësi i spërkave duhet të montohet në aeroplan për të minimizuar shmangien të shkaktuar nga vorbulla e majës së krahut ose rotorit. Gjatësia minimale praktike e spërkatësit duhet të përdoret dhe nuk duhet të kalojë 75% të shtrirje së krahëve ose 90% të diametrit të rotorit.

RUAJTJA DHE HEDHJA

Mos e kontaminoni ujin, ushqimin ose ushqimin e kafshëve përmes ruajtës ose hedhjes.

Ruajtja e pesticidit dhe procedurat e dredhjes: Ruajeni këtë produkt në kontejnerin origjinal të mbyllur mirë kur

nuk është në përdorim. Ruajeni në vend të freskët, të terur (preferohet të jetë i kyçur) që është synuar për insekticidet e atilla dhe gjithashtu është larg fëmijëve dhe kafshëve. Në rast të derdhjes, thitheni me material absorbuesi byk ose humus, fshijeni vendin dhe vendoseni në kontejner të shënuar dhe hidhni si vijon.

Hedhja e pesticidit: Mbeturinat që rezultojnë nga përdorimi i këtij produkti mund të hidhen në vendin e përdorimit ose në një stabiliment të dedikuar për hedhjen e mbeturinave.

Kontejnerët: Kontejneri që nuk rimbushet: Kontejneri metalik ose plastik. Mos e ripërdorni ose rimbushni kontejnerin. Shpëlajeni mirë tri herë ose me shtypje uji pas zbrazjes. Pastaj ofroni për riciklim ose rinovim, ose shpojini dhe hidhni në një deponi sanitare, ose përmes procedurave të tjera nëse është e lejuar nga organet shtetërore ose lokale. Shpëlajini tri herë si në vijim:

Kontejnerët prej 18 litrash ose më pak: Zbrazeni përmbajtjen e mbetur në pajisjen për aplikim dhe kullojeni 10 sekonda pasi që të fillojë të pikojë. Mbusheni ¼ e kontejnerit me ujë dhe mbylleni. Tundeni 10 sekonda. Hidhni preparatin shpëlarës në rezervuarin për përzierje ose ruajeni shpëlarësin për përdorim të mëvonshëm ose hedhje. Kullojeni 10 sekonda pasi që të fillojë të pikojë. Përsëriteni këtë procedurë edhe dy herë. Pasi që të pastrohet, ofroni për riciklim ose rinovim, ose shpojini dhe hidhni në një deponi sanitare, ose përmes procedurave të tjera nëse është e lejuar nga organet shtetërore ose lokale. Mos i pritni dhe mos i saldoni kontejnerët metalik.

Kontejnerët më të mëdhenj se 18 litra:

Zbrazeni përmbajtjen e mbetur në pajisjen për aplikim. Mbusheni ¼ e kontejnerit me ujë. Zëvendësoni dhe mbyllini mirë kapakët. Shtrijeni kontejnerin anash dhe rrotullojeni përpara-prapa, duke e bërë së paku një rrotullim të plotë, rreth 30 sekonda. Çojeni kontejnerin dhe tundeni fundin dhe pjesën e epërme të tij para-prapa disa herë. Hidhni preparatin

shpëlarës në rezervuarin për përzierje ose ruajeni shpëlarësin për përdorim të mëvonshëm ose hedhje. Përsëriteni këtë procedurë edhe dy herë. Pasi të pastrohet otronë për riciklim ose rinovim, ose shpojini dhe hidhni në një deponi sanitare, ose përmes procedurave të tjera nëse është e lejuar nga organet shtetërore ose lokale.

Shpëlarësi me shtypje si vijon (të gjitha madhësitë): Zbrazeni përmbajtjen e mbetur në pajisjen për aplikim dhe kullojeni 10 sekonda pasi që të fillojë të pikojë. Mbajeni kontejnerin përmbys mbi pajisjen aplikuese ose përzieni rezervuarin ose mbledhëni shpëlarësin për përdorim ose hedhje të mëvonshme. Futeni pipëzën shpëlarëse me shtypje brenda kontejnerit dhe shpëlarëni në rreth 40 PSI së paku 30 sekonda. Kullojeni 10 sekonda pasi që uji të fillojë të pikojë.

VINI RE: Blerësi dhe përdoruesi i pranojnë të gjitha rreziqet dhe përgjegjësitë e përdorimit, ruajtjes dhe/ose bartjes së këtij produkti në kundërshtim me kushtet në këtë etiketë.

GARANCIA E BLERËSIT E KUFIZUAR NGA KUSHTET E DHËNA NË ETIKETË

Univar Environmental Sciences
11205 Four Points Drive
Building 1, Suite 210
Austin, TX 78726


EPA Nr. i regj. 73748-1

Me nënshkrimin dhe vulën time vërtetoj që përkthimi i lartpërmendur (përfundimisht me faqen nëntë/9) përputhet me origjinalin e bashkëngjitur.

Prizren,
31.10.2015



Agim Susuri,



Përkthyes i autorizuar i
Gjykatës Themelore në Prizren,
Republika e Kosovës
Mobil: 044/190-753
E-mail: agimsusuri@hotmail.com

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ, RR.ADEM JASHARI, 15000, OBILIQ,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: OB614-20-6585-2-2-5

Nr i brendshëm: 614 20 069 225

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Jusuf Berisha, Musine Kokalari nr.2, 20000, PRIZREN, Kosovë

E-mail: jusufb.1@gmail.com

Personi kontaktues: Jusuf Berisha

Telefoni: 044/217101